



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 808/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Hazirii anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Majlinda Sylejmani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Majlinda Sylejmani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me shenjë ZL.Anr.808/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apel me datë 09.11.2017 në ora 21:00, nga Majlinda Sylejmani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me të cilën pretendon se në fshatin Rufc i Ri, në Qendrat e Votimit QV nr. 1323/01R, 1323e/02R, 1323E/03R, 1323E/04D, 1312E, 1322E/01R1303E/01R1329E/01D, 1329E/02D, numëri i votave nuk është i saktë dhe korrekt, prandaj PZAP-it i ka kërkuar rinumërimin e votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në apelin e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në fshatin Rufe i Ri, në Qendrat e Votimit QV nr. 1323/01R, 1323E/02R, 1323E/03R, 1323E/04D, 1312E, 1322E/01R1303E/01R1329E/01D, 1329E/02D, si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në apel nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në apel i parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Paneli gjatë vendosjes për një apel i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në apel të apeluesit vlerëson se pretendimet në apel, apeluesi nuk i ka argumentuar me prova bindëse, ndërsa provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk paraqesin referenc ligjore për marrjen e vendimit në favor të apeluesit

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Anr.808/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltëne Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*